



**AKT -THEMELIMI  
I SHOQERISE TREGTARE  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "POÇI 2004" Sh.p.k**

1. Niko Poçi , i biri i Theodharaqit, i dt/lindjes 1963, lindur dhe banues ne fshatin Badlonje te rrethit Permet, madhore e me zotesi te pote juridike per te vepruar, i cili ka vendosur te krijoje nje shoqeri tregtare , me pergjegjesi te kufizuar konform vullnetit te tij te lire dhe ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" , ligjit nr.7667 date 28.1.1993 " Per rregjistrin tregtar " si dhe ligjeve te tjera ne fuqi ,si me poshte :

Neni 1

Te themeloje nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar per te ushtruar veprimtari tregtare, te emertuar "Poçi 2004" sh.p.k. Kjo shoqeri tregtare do te kete seline ne Badlonje te rrethit Permet . Administratori i shoquerise eshte z. Niko Poçi dhe do te zhvilloje veprimtari tregtare per nje periudhe 20 vjeçare me te drejtë riperteritjeje e qe mund te cele filiale edhe ne qytete te tjera te vendit.

Neni 2

Sipas legjislacionit shqiptar shoqeria tregtare "Poçi 2004" Sh.p.k eshte person juridik dhe aktivitetin e saj e rregullon ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligjit 7667 date 28.1.1993, si dhe normat e parashikuara ne kete akt themelimi dhe statut qe i bashkengjitet ketij akti themelimi. Shoqeria i per gjigjet marredhenieve me te tretet vetem me fondet e veta dhe per gjigjet per detyrimet e kesaj shoqerie.

Neni 3

**OBJEKTI i veprimtarise se shoquerise "Poçi 2004" Sh.p.k. do te jetë :**

Tregtim artikuj te ndryshem ushqimore, industriale, elektroshtepiake, elektrike, elektronike, konfeksione, fruta perime, veshmbathje, kanceleri, hidraulike, materiale ndertimi si gure, granile ,te dryshme, betone e tjera detergjente, hidroasanitare, mobilje, grumbullim e tregtim bime mjekesore, floktore, punime duroalumini, mobilje druri, marangozi, hotel, motel, bar-kafe, restoran, piceri, rrobaqepsi, lojra femijesh, tregtimin e transportimin e tyre me shumice e pakice, transport tokesor te mallrave dhe te udhetareve import-eksport brenda dhe jashte vendit.

Neni 4

Kapitali themeltar i shoquerise eshte 100 000 leke.( njeqindmije), kapital fillestar i ortakut te vetem te shoquerise "Poçi 2004 " Sh.p.k

Neni 5

Kapitali themeltar i shoquerise perfaqeson kapitalin e derdhur nga ortaku i vetem i shoquerise "Poçi 2004" Sh.p.K. Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne shoqerine tregtare de te shenohet dhe kapitali i derdhur nga ortaku i shoquerise. Rritja e kapitalit nga ortaku i vetem nuk eshte e kufizuar.

Neni 6

Shoqeria vazhdon veprimtarine e saj ne baze te regjistrimit si person juridik ne Gjykaten e shkalles se pare Tirane si dhe rregjistrimin e saj po ne kete gjykate ne rregjistrin tregtar.

Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete akt themelimi ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga ortaku i vetem. Fitimi i realizuar nga veprimtaria tregtare e shoqerise pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet do te jete i gjithe i ortakut te vetem dhe eshte plotesisht i transferueshem per tu perdonur nga ortaku i vetem ose per tu depozituar ne nje nga bankat shqiptare.

Neni 7

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Ortaku i vetem i shoqerise "Poçi 2004" shpk qe eshte njekohesisht dhe administratori i shoqerise.

Modalitetet per perberjen dhe funksionimin e organeve te mesiperme percaktohen ne statutin e shoqerise.

Neni 8

Administratori i shoqerise "Poçi 2004" Sh.p.k., eshte z. Niko Poçi, i cili perjegjet per pasojat e demshme e te shkeljeve ndaj ligjit per shoqerite tregtare.

Neni 9

Vlefshmeria e aktit te themelimit:

Ky akt themelimi eshte i vlefshem per nje periudhe 20 vjecare me te dreje riparteriteje.

Ortaku i vetem i shoqerise vendos ne cdo kohe mbylljen ose zgjatjen e afatit.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarreveshjeve do te behet konform normave per rregullimin e mosmarreveshjeve per shoqerite tregtare ne gjykaten e Shkalles se Pare Tirane.

Neni 11

Dispozitat me te detajuara per shoqerine tregtare "Poçi 2004" sh.p.k. jane te percaktuara dhe permbahen ne statutin e kesaj shoqerie.

Neni 12

Problemet qe nuk jane trajtuar ne aktin e themelimit apo ne statutin e shoqerise dhe qe do te dalin gjate aktivitetit te shoqerise do te zgjidhen mbi bazen e dispozitave te Kodit Tregtar dhe atij Civil te Republikes se Shqiperise.

Neni 13

Shoqeria do te kete vulen e vet me mbishkrimin shoqeria "Poçi 2004" Shpk Tirane.

Neni 14

Ky akt themelimi formulohet ne kater kopje nga te cilat njera depozitohet ne zyren e noterise ne Tirane, njera ne gjykaten e Shkalles se Pare Tirane, njera ne zyren e tatimeve dhe nje kopje mbahet ne dokumentet e shoqerise.

Ky akt themelimi eshte i vlefshem qe nga momenti i nenshkrimit te tij nga ortaku i vetem i shoqerise "Poçi 2004" Sh.p.k dhe nenshkrimit te noterit.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE  
NIKO POÇI**





## STATUT



### I SHOQERISE TREGTARE "POÇI 2004" Sh.p.k

Shoqeria tregtare "Poçi 2004" Sh.p.k. eshte krijuar sipas aktit te themelimit te kesaj shoqerie nga ortaku i vetem :

1. Niko Poçi , i biri i Theodhoraqit, i dt/lindjes 1963, lindur dhe banues ne fshatin Badlonje te rrethit Permet, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar, i cili ka vendosur te krijoje nje shoqeri tregtare , me perqegjesi te kufizuar konform vullnetit te tij te lire dhe ligjt nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" , ligjt nr.7667 date 28.1.1993 " Per rregjistrin tregtar " si dhe ligjeve te tjera ne fuqi ,si me poshte :

#### **KREU I PARE DISPOZITA TE PERGJITHSHME ( forma, emertimi,objekti,selia ,kohezgjatja)**

##### Neni 1

Ortaku i vetem i lartepermendor , ka krijuar nje shoqeri tregtare me perqegjesi te kufizuar "Poçi 2004" Sh.p.k. Shoqeria tregtare e ka fituar te drejten e personit juridik me rregjistrimin e saj ne gjykaten e shkalles se pare Tirane si dhe regjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar te kesaj gjykate.

##### Neni 2


Emertimi i shoqerise tregtare eshte "Poçi 2004 " sh.p.k. Selia e shoqerise tregtare "Poçi 2004" Sh.p.k. eshte ne fshatin Badlonje te rrethit Permet. Kohezgjatja e shoqerise tregtare eshte parashikuar per nje periudhe 20 vjeçare me te drejte riparteritjeje. Kapitali themaltar i shoqerise tregtare eshte 100 000 leke (njeqindmije leke).dhe ka si objekt te saj:

Tregtim artikuj te ndryshem ushqimore, industriale, elektroshtepiake, elekrike, elektronike, konfeksione, fruta perime, veshmbathje, kanceleri, hidraulike, materiale ndertimi si gure, granile ,te dryshme, betone e tjera detergjente, hidrosanitare, mobilje, grumbullim e tregtim bime mjekesore, floktore, punime duroalumini, mobilje druri, marangozi, hotel, motel, bar-kafe, restorant, piceri, rrobaqepsi, lojra femijesh, tregtimin e transportimin e tyre me shumice e pakice, transport tokesor te mallrave dhe te udhetareve import-eksport brenda dhe jashte vendit.

##### Neni 3

Kapitali themaltar eshte derdhur nga ortaku i vetem i kesaj shoqerie , kapital i gjithe i ortakut te vetem.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj. Zmadhimi ose zvegelimi i ketij kapitali vendoset nga ortaku i vetem i shoqerise. Kapitali themaltar mund te transferohet tek te tretet vetem pas miratimit nga ana e Ortakut te vetem te shoqerise.



## KREU U DYTE ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

### Neni 4

Organi vendimor i shoqerise eshte asamblea e ortakeve.

Administratori i shoqerise vendos per cestje te tilla si emertimin ose shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive, ndarjen e fitimit, ndersa ortaket kane te dreje te beje ndryshimet ne statut, zvogelimin ose zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e afatit te veprimtarise se shoqerise apo likuidimin e saj, shnderrimin e shoqerise me perjegjesi te kufizuar ne nje nga format e kerkuara nga ligji etj.

### Neni 5

Ortaku i vetem i shoqerise mbledhjet e zakonshme i ben cdo vit brenda 4 muajve nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te shoqerise.

### Neni 6

Shoqeria administrohet nga administratori z. Niko Poçi. Ne marredhenie me te trete administratori i ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise.

### Neni 7

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar nga administratori i shoqerise dhe te miratuar ne mbledhjen e radhes qe do te beje ortaku i vetem i shoqerise dhe mund te emerohet per tre vite financiare me mundesi rizgjedhjeje. Shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar vendoset ne te njejta kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ne punen e tij gje qe e ben te pamundur kryerjen e detyres.


### Neni 8

Per punonjesit qe do te punesohen ne shoqerine tregtare do te zbatohen aktet ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim duke lidhur kontratat e punes me secilin per nje afat jo me shume se periudha nje vjecare. Paga e punes nuk eshte e kufizuar por ajo nuk mund te jete me e ulet se ajo e percaktuar me vendime te vecanta te Qeverise. Numri i punonjesve eshte i pa kufizuar.

## KREU I TRETE MARREDHENIET EKONOMIKE – FINANCIARE

### Neni 9

Viti finanziar fillon me daten 1 janar dhe mbaron me daten 31 dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit finanziar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar. Miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda muajit mars te vitit pasardhes.



#### Neni 10

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te egzistences se fitimit Ortaket e shoqerise percaktojne pjesen qe i takon secilit mbasi te jene zbritur ose shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme. Fitimin neto te realizuar nga veprimitaria e shoqerise kane te drejte ta perdonin secili ortak per llogari te tij si dhe ne interes te shoqerise.

#### Neni 11

Llogarite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne leke ose dhe ne valute te huaj. Veprimitaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim dhe mbeshtetet ne aktivin dhe pasivin qe detyrimisht do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet mbajne perjegjesi ligjore per punen e tyre.

#### Neni 12

Shoqeria tregtare me qellim qe te beje sa me te lehte dhe me te shpejte pagesat me te tretet do te hapi nje llogari bankare ne nje nga baknat e shtetit shqiptar.

Shoqeria do te kete vulen e saj me emrin e shoqerise "Poçi 2004" sh.p.k. dhe do te perdoret vetem nga administratori i shoqerise.

### **KREU I KATERT** **ZGJATJA E AFATIT , PRISHJA , LIKUIDIMI**

#### Neni 13

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne aktin e themelimit, zgjatja e tij behet vetem me vendim te ortakut te vetem te shoqerise "Poçi 2004" "Sh.p.k. Ajo prishet kur mbaron afati i percaktimit dhe kur ortaket nuk bien dakord qe te bejne riparteritjen e ketij afati. Shoqeria mund te shnderrohet ne nje nga format e percaktuara nga ligji dhe ne formen e kerkuar nga ligji.

#### Neni 14

Shoqeria tregtare, hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj. Per fillimin e ketij procesi, ortaku i vetem i shoqerise "Poçi 2004" Sh.p.k. emeron nje likuidues , i cili paraqet raportin e likuidimit, gjendjen e aktivit dhe te pasivit te shoqerise, mbi menyren e ndjekjes se operacionit te likuidimit dhe afatin e nevojshem per perfundimin e tyre. Ne fund te procesit te likuidimit asamblea e ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar, mbi aktin dhe rregullsine e likuidimit, mbi mbylljen e procesit te likuidimit te shoqerise.

#### Neni 15

Te gjitha mosmarreveshjet qe do te lindin gjate ekzekutimit te ketij statuti dhe aktit te themelimit gjate egzistences se shoqerise si gjate kryerjes se veprimitarise ashtu dhe ne procesin e likuidimit do ti drejtohen per gjykim gjykates se shkalles se pare Tirane.

Neni 16

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zgjidhet sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise si dhe ligjt " Per shoqerite tregtare" nr.7638 date 19.11.1992.

Neni 17

Ortaku i vetem i shoqerise " Poçi 2004 " Sh.p.k. ka te drejte te beje ndryshime dhe depozitim vendimesh per sa i perket shtimit apo zvogelimit te numrit te ortakeve, dhe objektit te veprimtarise apo ndryshimit te emrit te shoqerise.

Neni 18

Shoqeria "Poçi 2004 " Sh.p.k. ka te drejte te hapi dege ose filiale te tjera ne qytete te tjera te vendit dhe te kete perfaquesuesit e saj per ushtrimin e aktivitetit tregtar sipas rregullave dhe ligjeve ne fuqi.

Neni 19

Ky statut eshte hartuar ne kater kopje ku njera kopje depozitohet ne zyren e noterise Tirane, nje kopje ne gjykaten e shkalles se pare Tirane, nje kopje ne zyren e tatimeve dhe nje kopje mbahet ne dokumentet e krijimit te shoqerise.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE  
NIKO POÇI**

*Niko Poçi*

**REPUBLICA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE  
Nr. 1596 Rep.**

**VERTEZIM**

Sot me daten 05/05/2004 ne zyren e noterise ne Tirane u paraqit personalisht ortaku i vetem i shoqerise tregtare "Poçi 2004 " Sh.p.k, z. Niko Poçi, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar , per identitetin e te cilit u bazova ne dokumentin identifikues, i cili deklaroi se, akti i themelimit dhe statuti i kesaj shoqerie eshte perpiluar jashtë zyre noterie me vullnetin e tij te lire dhe te plete e nenshkroi rregullisht para meje dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

